

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Falsifikim dokumentesh dhe shpërdorim detyre/ Arrestohen dy ish-drejtorë të ASHK-së në Fier
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/falsifikim-dokumentesh-dhe-shperdorim-detyre-arrestohen-dy-ish-drejto-i474430
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:30:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:19:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a792c1f9461b4e7487820c0705c3a81ae4f2a7b4dc387162ac346ae07e80c49e
TEKSTI	31e0dc47df312e561b8b3fc80eab305384a38170a989de9dccbd050088b0ba7
PAMJA	36abd0d0dbb66f9413be2974992158e8a4e2049e7aa7cd2abd63f8eaa1cda87d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	df7e7f1d26f60c1b28c97101e02e752cf4fcd252ca5515d69f0cc4088809aad6
E MËPARSHMJA	37f2d91c1fbb16b246ed790a1ba7b6b7c8f008ebf6453087655429df6fbff188
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/df7e7f1d26f60c1b28c97101e02e752cf4fcd252ca5515d69f0cc4088809aad6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

10:54 Politikë

Kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla gjatë fj...

Falsifikim dokumentesh dhe shpërdorim detyre/ Arrestohen dy ish-drejtorë të ASHK-së në Fier



17 Shtator 2026, 10:19, Aktualitet CNA



Dy ish-drejtorë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë arrestuar me kërkesë të Prokurorisë së Fierit për falsifikim dokumentesh të një sipërfaqe toke dhe shpërdorim detyre. Në pranga janë vënë edhe një specialist i ASHK-së dhe shtetasi K.H., përfitues i pronës.

Sipas njoftimit të Prokurorisë, shtetasi K.H., duke paraqitur si tituj pronësie dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier, ka arritur të regjistrojë në bashkëpronësi të tij dhe katër personave të tjerë një sipërfaqe toke prej 1,143 hektarësh, si dhe 150.000 euro të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier.

Më pas, shtetasi K.H., duke u paraqitur në cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit edhe të bashkëpronarëve të tjerë, me anë të një prokure të posaçme të falsifikuar, u ka shitur këtë tokë dy shoqërive të ndryshme.

Shtetasit E.Sh. dhe B.K., në cilësinë e drejtorëve të ASHK, Fier, dhe shtetasi P.Ç., në cilësinë e specialistit, jurist, pranë ASHK në Fier, kanë regjistruar pasuritë në fjalë në bashkëpronësi të shtetasit K.H., në kundërshtim me ligjin.

Ndërkohë bëhet me dije se në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarësh tokë si dhe 150.000 euro.

Njoftimi i plotë:

Arrestohen me kërkesë të Prokurorisë Fier për falsifikim dokumentesh e shpërdorim detyre, dy ish-drejtorë të ASHK-së, specialisti dhe përfituesi i pronës, sekuestrohen 1143 ha tokë

Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier u vendos masa e sigurimit personal 'Arrëst në burg' ndaj katër shtetasve E.Sh., B.K. në cilësinë e drejtorëve të ASHK, P. Ç. specialistit, jurist, pranë ASHK dhe K.H., përfituesi i pronave nën akuzë për veprat penale 'Falsifikim i dokumenteve', 'Shpërdorimi i detyrës' si dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale" të parashikuara nga nenet 186/2, 248 dhe 287, prq.2, të Kodit Penal.

Po kështu, në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarë tokë (e barabartë me njëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e gjashtë m2), si dhe 150.000 euro.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë hetimeve të deritanishme për procedimin penal nr. 1026 të vitit 2025, kryer në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nëpërmjet përdorimit edhe të metodave proaktive, arriti të provojë se:

Shtetasi K.H., duke paraqitur si tituj pronësie dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier, ka arritur të regjistrojë në bashkëpronësi të tij dhe katër personave të tjerë një sipërfaqe të konsiderueshme toke prej 1,143 hektarë të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier.


Më pas, ky shtetas, duke u paraqitur me cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit edhe të bashkëpronarëve të tjerë, me anë të një prokure të posaçme të falsifikuar, u ka shitur këtë tokë dy shoqërive të ndryshme.

Shtetasit E.Sh. dhe B.K., në cilësinë e drejtorëve të ASHK, Fier, dhe shtetasi P.Ç., në cilësinë e specialistit, jurist, pranë ASHK, Fier, kanë regjistruar pasuritë në fjalë në bashkëpronësi të shtetasit K.H., në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM nr. 639, datë 16.10.2024, dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", duke mos kërkuar sipas këtyre akteve ligjore/nënligjore konfirmimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier nga Agjencia e Trajtitimit të Pronës, verifikim nga i cili do të rezultonte se këto vendime janë të falsifikuara.

*Për më tepër, ka rezultuar se shtetasi B. K., ish drejtor i ASHK, Fier, kur ka regjistruar pasurinë nr. 3**, zk 3358, ka tejkaluar edhe sipërfaqen që sipas vendimit të falsifikuar nr. 8*, datë 20.01.1997, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Këshillit të Rrethit Fier, i ishte kthyer ish-pronarit Th.S., duke përfituar për rrjedhojë shtetasi K.H. edhe një sipërfaqe tjetër të konsiderueshme toke në pronësi.*

Gjithashtu, shtetasit E.Sh. e P.Ç. gjatë regjistrimit të pasurive kanë ndryshuar zërin kadastral të sipërfaqes së regjistruar në pronësi të shtetasve K.H., etj, nga tokë arë në tokë pa frut, pa një akt administrativ nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier.

Masat e sigurimit personal dhe pasuror u ekzekutuan nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier në bashkëpunim me shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë si të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. /CNA





Të sugjeruara

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ PD-mazhorancës: Të dalim me qëndrim të përbashkët

Sot protestë para Parlamentit/ Policia merr masat, vendoset gardhi metalik

Çmimet e larta të karburanteve/ Konfindustria kërkon ulje të ngarkesës fiskale: Rrezikohet ekonomia

Zbardhen vendimet e qeverisë/ 17 ushtarakë dhe një helikopter, në operacionin ushtarak ndërkombëtar "KEFOR"

Dita e 109 e protestës/ Tubimi mbyllet te busti i Adem Jasharit

Emërohet zëvendësministri i ri i Ekonomisë dhe Inovacionit

Banorët e Divjakës protestojnë për 48 ditë

Vendimi për Hashim Thaçin/ Fevziu: Shokuese, u dënua pa asnjë fakt

Protesta e 109/ Qytetarët "zbarkojnë" sërish para Kryeministrit

Arrestohet kushëriri i Ergys Agasit

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Gjokutaj: Pa vendngjarje nuk ka çështje, procesi është i parregullt

Çarja e tubacionit në Bogovë/ Prej mesditës, Berati e Kuçova pa ujë të pijshëm

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Peleshi: Vendimi i sotëm nuk i njollos dot heronjtë e Kosovës

Propozimi i PS-së për pagat në sistemin e drejtësisë/ Gjykata e Lartë: Kuvendi nuk duhet ta miratojë, ja pse

Projektligji për pagat e magjistratëve/ Gjykata e Lartë: Konsultim i mangët, shpërfillje e hapur nga Kuvendi

Si ndryshoi skema e blerjes së drejtësisë pas vendimit ndaj Erion Veliajt?!

Jeta mes botimeve dhe shkencës/ Historiani Aurel Plasari feston 70-vjetorin e lindjes

SHBA vlerëson punën e SPAK/ Lawton: Ka qenë efektive

Nesër është një ditë e veçantë!


Dita e 108/ Protestuesit shkojnë te "Mine Peza"

[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.